



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

KOMUNA KLINË
DREJTORIA E ARSIMIT
04 Nr. 111-4224 2016
Klinë, më 05.10.2016

Mbështetur në nenin 8, pika 1, të Ligjit të punës nr. 03/L-212 si dhe në nenin 5, pika c, të Ligjit nr. 03/L- 068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, të Ligjit nr.04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës si dhe në Normativin mbi përzgjedhjen e kuadrit profesional të arsimit të përgjithshëm nr. 06/2015, si dhe duke u mbështetur në Vendimin e Ministrit të Arsimit, të datës 4 gusht 2015, ref.nr.231/01B, po ashtu në Vendimin e SIA-s (Pejë) ref.nr.10/1-5, të datës 1.9.2016 si dhe në Vendimin e Departamentit të Inspektimit të Arsimit (MASHT) nr.10/433, datë 20.9.2016, Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë publikon:

K O N K U R S

I.Shkolla fillore “ Dëshmorët e Qëndresës ” Gllarevë

Dy mësimdhënës për gjuhë angleze (njëri për 20 orë, tjetri për 18 orë)

II.Shkolla fillore “Ali Krasniqi ” Ujmirë

Një mësimdhënës për gjuhë angleze me 19 orë

III.Shkolla fillore “Atë Shtjefën Gjeçovi” Zllakuqan

Një mësimdhënës për gjuhë angleze për 10 orë

IV.Shkolla fillore “ Isa Boletini” Drenoc

Një mësimdhënës për gjuhë angleze me 18 orë

V.Shkolla fillore “Ymer Berisha” Siqevë

Një mësimdhënës për gjuhë angleze 18 orë

VI.Shkolla fillore “ Zgjimi “ Gremnik

Një mësimdhënës për gjuhë angleze 20 orë

VII.Shkolla fillore “ Dëshmorët “ Volljak

Një mësimdhënës për gjuhë angleze 20 orë

VIII.Shkolla fillore “ Tre Dëshmorët “ Jashanicë

Një mësimdhënës për gjuhë angleze 18 orë

IX.Shkolla fillore “ Avni Zhabota “ Shtupel

Dy mësimdhënës për gjuhë angleze (njëri për 20 orë dhe tjetëri me 14 orë)

X.Shkolla fillore “ Azem Bejta “ Grabanicë

Plotësim norme për gjuhë angleze me 6 orë .

UDHËZIM PËR APLIKIM

1. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në DKA brenda orarit zyrtar të punës (prej orës 8-16).
2. Dokumentet për dorëzim: fotokopje e noterizuar e diplomës (nëse është certifikatë e notave duhet të jetë origjinale), kopje e dokumentit të identifikimit si dhe kopje të ndonjë dëshmie shtesë (licenca, trajnime, përvoja e punës në arsim etj.). **Dokumentet e pakompletuara nuk do të pranohen si dhe dokumentet e konkurrimit nuk kthehen.**
3. Kandidatët kanë të drejtë të aplikimit vetëm për një vend pune.
4. Afati i konkurrimit është 10 ditë nga data e shpalljes publike.
5. Në intervistë do të ftohen kandidatë që i plotësojnë kushtet në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2015, si dhe UA nr.17/2009 për procedurat e zgjedhjes së personelit arsimor në shkollë (sipas listës së ngushtë).
6. DKA-ja orarin e intervistimit dhe listën e ngushtë të kandidatëve do ta bëjë publike në faqen zyrtare të Komunës.

